

Programi

Johannes Brahms (1833-1897)

Sonata nr. 3 op. 108 për piano e violin

1. Allegro
2. Adagio
3. Un poco presto e con sentimento
4. Presto agitato

Sergei Prokofiev (1891-1953)

Sonata nr. 1 op. 80 për violin e piano

1. Andante assai
2. Allegro brusco
3. Andante
4. Allegrissimo



organizon:

Ermir Abeshi
violin

Merita Rexha Tërshana
piano

Në program Brahms, Prokofiev

Salla e Universitetit të Arteve
e enjte 19 dhjetor 2013, ora 19:00

Radha _____ Karrige _____

Çmimi 300 leke



Ermir Abeshi

Finalist i Konkursit Ndërkombëtar për violin Queen Elisabeth në Bruksel dhe fitues i çmimit të dytë në Konkursin Ndërkombëtar për violin "Lipizer" në Gorizia, Itali.


Ermir Abeshi ka performuar si solist me orkestrën kombëtare të Belgjikës, në prestigjozin in Palais des Beaux-Arts në Bruksel drejtuar nga Gilbert Varga, me orkestrën Royal de Chambre du Vallonie dhe orkestrat simfonike rumune te Ploieti dhe Bacau në drejtimin e Ovidiu Balan.

Në moshën 16 vjeçare ka debutuar me orkestrën simfonike "Ghedini" në drejtimin e Mark Foster. Gjithashtu ka debutuar si solist në prestigjozin Jordan Hall në Boston me New England Conservatory Chamber Orchestra.

Ka lindur në Elbasan në vitin 1987 me shtetësi shqiptaro-amerikane, fillon studimet në moshën 6 vjeçare në qytetin e tij. Në moshën 10 vjeçare shkon në Itali ku studjon në Konservator dhe diplomohet shkëlqyeshëm në vitin 2005 në drejtimin e Bruno Pignata si dhe ndjek Akademinë "Walter Stauffer" ku studjon me violinistin e famshëm italian Salvatore Accardo.

Në vitin 2006 shkon në Boston ku kryen Master e Graduate Diploma në New England Conservatory ku studjon me Malcolm Lowe, Boston Symphony Orchestra Concert-master. Gjatë kësaj kohe ai ndjek programet verore dhe master-klasë me Ilya Grubert, Pinchas Zucherman dhe Grigory Zhislin, studjon muzikë dhome me Nicholas Kitchen i Borromeo String Quartet dhe Paul Biss, si dhe kompozicion me Michael Gandolfi dhe John Mallia.

Aktualisht është duke studjuar violin me Dora Schwarzberg dhe muzikë dhome me pianistin italian Enrico Pace.



Merita Rexha Tërshana

Merita Rexha Tërshana ka lindur në Tiranë ku dhe ka filluar studimet në piano. Ka përfunduar Liceun Artistik e më pas Akademinë e Arteve në vitin 1994, në klasën e prof. Margarita Kristidhi me rezultate të shkëlqyera. Gjatë dhe pas përfundimeve të studimeve ka marrë pjesë dhe ka ndjekur disa kurse perfeksionimi kryesisht në Gjermani me pianistë si Paul Badura-Skoda, Till Engel, etj. Merita Rexha Tërshana është nga pianistët më aktive të jetës muzikore shqiptare. Ajo ka luajtur si soliste me orkestrën simfonike të RTSh, orkestrën e Teatrit të Operas e Baletit, orkestrën e Akademisë së Arteve, në drejtimin e ditigjentëve shqiptarë dhe të huaj si L. Quinot, L. Quadrini, B. Llapaj, Zh. Ciko, A. Lepuri, J. Barbullushi, D. Kuraja.

Është aktivizuar si soliste dhe në asamble të muzikës së dhomës në festivale të rëndësishme si Schleswig-Holstein Music Festival në Gjermani, Bregenz Festspiel në Austri, Kamermusik Festival në Kosovë, në Itali, Danimarkë, Zvicër, Greqi, Maqedoni, etj.

Repertori i saj përfshin vepra që nga Barok e deri te muzika bashkohore. Ka luajtur disa premiera të kompozitorëve shqiptarë si dhe në festivalin "Vjeshta e Tiranës" ka luajtur integralen e veprave të Xenakis para vetë kompozitorit. Ka regjistruar disa cd me vepra të kompozitorëve shqiptarë si dhe një cd me vepra të Schumann-it.

Fituese e çmimit Interpretuesja më e mirë në vitin 1996 në Festivalin e Muzikës Shqiptare, tre herë e nominuar për çmimin interpretuesja më e mirë e vitit, në 2004, 2006, 2009, dhe fituese e çmimit Kult në vitin 2010.

Merita Rexha Tërshana është pedagoge e pianos në Universitetin e Arteve dhe që nga viti 2007 mban titullin Profesor i Asociuar.